

V E N D I M
Nr.213, datë 16.11.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i““““
Gjergji Sauli	Anëtar i““““
Alfred Karamuço	Anëtar i““““
Kristofor Peçi	Anëtar i““““
Kujtim Puto	Anëtar i““““
Sokol Sadushi	Anëtar i““““
Petrit Plloçi	Anëtar i““““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 16.11.2001, mori në shyrtrim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.178, Akti që i përket:

KËRKUES: GENCI MUHARREMI, përfaqësuar nga avokat Vasil Dode.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, marrë në Dhomën e Këshillimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g e 142/1 të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e vendimit të mësipërm kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Rekursi i paraqitur në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale. Megjithatë, ky Kolegj nuk e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore, por në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit.

Ky vendim i Kolegjit Penal vjen në kundërshtim me nenet 42/1 e 142/1 të Kushtetutës, sepse na ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi, përfaqësuesin e kërkuetit dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Avokati Vasil Dode, në emër të të gjykuarit Genc Muharremi, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.167, datë 27.2.2001 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore rezultoi se avokati Vasil Dode, nuk është pajisur me prokurë nga ana e kërkuetit për ta përfaqësuar atë përpara Gjykatës Kushtetuese.

Në këto kushte, avokati nuk mund ta përfaqësojë atë e, për pasojë, nuk mund të paraqesë kërkesë në emër të tij.

Në këto rrethana duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.